

REUSEFUL

PROJEKTI REUSEFUL

PROJEKTI: REUSEFUL – Promovimi i reduktimit të mbetjeve përmes qendrave të ripërdorimit në zonën e Adriatikut të Jugut

PROGRAMI: Interreg IPA Adriatiku Jugor

AKSI PRIORITAR: PA 2 – Një zonë më e gjelbër e Adriatikut të Jugut, duke promovuar një tranzicion të pastër dhe të drejtë të energjisë, investimet e gjelbra dhe blu, ekonominë qarkulluese, përshtatjet klimatike dhe menaxhimin e riskut.

OBJEKTIVA SPECIFIKE: S.O.2.2.: Përmirësimi i mbrojtjes dhe ruajtjes së natyrës, biodiversitetit dhe infrastrukturës së gjelbër, duke përfshirë zonat urbane dhe duke reduktuar të gjitha format e ndotjes.

PARTNER:

- Komuna e Ostunit (Partneri Kryesor)
- Komuna e Triventos
- Bashkia e Shkodrës
- Komuna e Ulqinit

Partnerë mbështetës:

- Bashkimi i Komunave të Medio Sannio
- SHPK Veprimtaritë Komunale Ulqin

Buxheti total: € 935.189,74

Kontributi i BE-së (82,41%): € 770.699,02

Kontributi kombëtar (17,59%): € 164.490,72

KOHËZGJATJA: 01/07/2025 – 31/12/2027 (30 muaj)



REUSEFUL

QËLLIMI I PROJEKTIT:

REUSEFUL adreson ndotjen në burim, duke promovuar reduktimin e mbetjeve që në fazat fillestare nëpërmjet një rrjeti ndërkufitar qëndrash ripërdorimi. Duke zgatur ciklin e jetës së produkteve, projekti redukton presionin e ushtruar në zonat me biodiversitet të larmishëm dhe mbështet prioritetin e BE-së për ripërdorim në hierarkinë e mbetjeve.

AKTIVITETET KRYESORE TË PROJEKTIT:

- Realizimi i një studimi bazë mbi menaxhimin e mbetjeve në territoret partnere (llojet/sasitë e mbetjeve, praktikat aktuale, nevojat).
- Krijimi dhe shpërndarja e materialeve ndërgjegjësuese dhe edukative mbi parandalimin e mbetjeve, ripërdorimit dhe ekonomisë qarkulluese.
- Organizimi i workshop-eve/eventeve lokale për të angazhuar qytetarët, shkollat, të rinjtë dhe palët e interesuara ("ripërdor më shumë, hidh më pak").
- Krijimi i një modeli të përbashkët dhe të transferueshëm të një qendre ripërdorimi (projekti arkitekturor, nevojat për pajisje, rregullat operative).
- Ndërtimi dhe testimi i qendrave pilot të ripërdorimit në zonat partnere (Ostuni, Trivento, Shkodër dhe Ulqin).
- Përcaktimi i udhëzuesve praktikë për menaxhimin e qendrave të ripërdorimit (procedurat, siguria/cilësia, grumbullimi dhe rishpërndarja).
- Trajnimi i stafit dhe vullnetarëve për menaxhimin dhe operimin e qendrave të ripërdorimit.
- Organizimi i vizitave shkëmbyese/edukuese ndërkufitare, për të ndarë përvojat dhe përmirësuar qendrat pilot.
- Hartimi i përbashkët i Strategjisë Zero Mbetje, bazuar në të dhëna dhe rezultatet e pilotit.
- Publikimi i rezultateve nëpërmjet mënyrave të ndryshme të komunikimit dhe konferencës finale.

REZULTATET E PRITSHME:

- Rrjetëzimi i qendrave të ripërdorimit përgjatë gjithë zonës së programit, duke lidhur qendrat pilot mes tyre dhe duke lehtësuar të mësuarit e përbashkët, standardet e ndërsjella, shkëmbimin e praktikave dhe riaplikimin e tyre në të ardhmen.



REUSEFUL

- Strategjia Zero Mbetje do të përdoret nga organizatat (autoritetet lokale dhe palët e interesuara), duke kaluar nga një dokument në një politikë/mjet praktikash që udhëheq parandalimin e gjenerimit të mbetjeve, ripërdorimit dhe mbrojtjes së biodiversitetit.
- Ndryshimi i qasjes dhe rritja e pjesëmarrjes në praktikat e ripërdorimit, mbështetur nga aktivitetet ndërgjegjëse.
- Përfitime mjedisore dhe socio-ekonomike: sasi e reduktuar mbetjesh që depozitohen në landfill përmes ripërdorimit/riparimit, ndikim më i ulët në ekosistemet e ndjeshme dhe përmirësim i aksesit ndaj produkteve të përdorura me çmime të përballueshme për grupet vulnerabël në nevojë (personat në nevojë do të kenë përparësi në aksesin e mallrave, përpara se të shpërndahen për publikun e gjerë).

FAQJA E INTERNETIT E PROJEKTIT: reuseful.southadriatic.eu

RRJETET SOCIALE TË PROGRAMIT:

FACEBOOK: <https://www.facebook.com/interregipasouthadriatic>

INSTAGRAM: <https://www.instagram.com/interregipasouthadriatic/>

LINKEDIN: <https://www.linkedin.com/company/interreg-ipa-south-adriatic/>

KONTAKT:

Albi Çulaj – Menaxher projekti – Bashkia Shkodër

Albi.Culaj@bashkiashkoder.gov.al

